

KORONAVIRUS KOVID-19

Ndihmat dhe të drejtat e të huajve

20 maj 2020

Përmbledhje e pyetjeve (PEP) Përdorues azili

Unë dëshiroj të kërkoj azilin

- Regjistrimi i kërkesave të azilit do të fillojë nga data 6 maj në Île-de-France dhe gjatë javës së 11 majit për pjesën tjetër të territorit.
- Ju duhet të respektoni masat të cilat zbatohen në territorin tuaj për të patur mundësi të shkoni tek zyra që ju pret në fillim SPADA (platforma telefonike në Île-de-France dhe në rrethe të tjera) dhe më pas në sportelin e regjistrimit GUDA.
- **Kërkesa juaj e azilit nuk do të konsiderohet si e vonuar dhe të vendoset në procedurë të përshpjektuar** thjesht për arsyen se ju jeni në Francë për më shumë se 90 ditë, vetëm nëse ky afat do të mbaronte midis 12 marsit dhe 23 qeshorit 2020.

Kam shkuar në SPADA para 16 marsit por jo në GUDA

- Nëse ju nuk jeni kontaktuar nga GUDA apo nga SPADA për të finalizuar regjistrimin tuaj, ju duhet të lajmëroheni veçanërisht me telefon pranë SPADA për të përcaktuar me të përçapjet që duhen vazhduar më tej.

Jam regjistruar në GUDA por nuk e kam dorëzuar akoma kërkesën time në OFPRA

- **Afati prej 21 ditësh** për të dërguar kërkesën tuaj pranë Zyrës Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe të Njerëzve pa Shtetësi (OFPRA) i cili mbaron midis 12 marsit dhe 23 qeshorit 2020 është **pezulluar**. **Pika fillestare e afatit të shqyrtimit prej 21 ditësh është zgjatur deri më 24 qeshor 2020. Ju keni afat deri më 15 korrik 2020 për të bërë kërkesën tuaj të azilit tek OFPRA. Megjithatë nëse dëshironi, ju keni mundësi të dërgoni kërkesën tuaj të azilit tek OFPRA dhe para kësaj date.**
- Pra nuk ka **ndonjë urgjencë për të kontaktuar SPADA** në mënyrë që ajo t'ju ndihmojë për të përgatitur dosjen tuaj.
- **Të drejtat tuaja për të përfituar pagesën që i jepet azil kërkuarit (ADA)** do të vazhdojnë të llogariten duke filluar nga data e regjistrimit të kërkesës suaj në GUDA.

Unë jam në vazhdimësi të procedurës Dublin

- **Unë duhet të vazhdoj ti përgjigjem thirrjeve për takim të administratës dhe të zbatoj udhëzimet të cilat do të më jepen nga prefektura që shqyrton dosjen time.** Unë jam i informuar se çdo mungesë në një thirrje për takim që më është bërë nga administrata, do të thotë se unë nuk kam zbatuar siç duhet kërkesat e autoriteteve të cilat merren me azilin, për më shumë do të konsiderohem sikur jam arratisur.
- Afatet për tranfertën tuaj nuk janë zgjatur për shkak të gjendjes urgjente sanitare ; nëse Franca është caktuar përgjegjëse e ekzaminimit të kërkesës sime të azilit, unë do të marr një thirrje, **me postë**, në mënyrë që kërkesa ime e azilit të rikualifikohet në procedurë normale apo të përshpjetuar. **Në asnjë rast, nuk duhet të paraqitem spontanisht në prefekturë.**

Jam në vazhdimësi të procedurës në OFPRA

- **OFPRA do të fillojë takimet në mënyrë progresive**, duke filluar nga azil kërkuesit që jetojnë në Île - de-France.
- **Ju do të merrni një thirrje për tu paraqitur me mesazh dhe pas datës 11 maj me letër.**
- Nëse ju e keni adresën administrative në SPADA, ajo do ju informojë për t'ju lajmëruar në lidhje me thirrjen që keni marrë. **Nuk është e nevojshme të paraqiteni spontanisht në SPADA.** Ju mund të kontaktoni numrin e permanencës telefonike i cili është vënë në dispozicion nga SPADA në rrethin ku banoni.

Kam marrë vendimin nga OFPRA të cilin dua ta kundërshtoj

- Afati i dorëzimit të rekurit për një muaj tek Gjykata Kombëtare e të Drejtës së Azilit (CNDA) i cili mbaronte midis 12 marsit dhe 24 majit 2020 është pezulluar. Fillimi i nisjes së afatit për rekurin është shtyrë me datë 24 maj 2020 ; **ju keni afat e shumta deri me 25 qeshor 2020 për të përgatitur rekurin. Megjithatë, nëse keni dëshirë, ju mund ta bëni rekurin dhe para kësaj date.**
- Të gjitha vendimet të cilat nuk janë njoftuar gjatë kohës kur kemi qenë të mbyllur brenda, do të njoftohen sistematikisht dhe një herë duke filluar nga muaji qeshor.
- Nëse vendimi juaj është kthyer mbrapsht në OFPRA pa u vënë në dijeni për të, ju mund të kërkoni që OFPRA t'ju nisë përsëri vendimin.

Unë jam azil kërkues dhe vërtetimi im arrim drejt përfundimit të vlefshmërisë

- **Të gjitha vërtetimet e azil kërkuesve (ATDA) të cilave i mbaronte afati midis datës 16 mars dhe 15 qeshor 2020, janë shtyrë automatikisht për 90 ditë.**
- **Nuk është e nevojshme të shkoni në prefekturë** apo ta kontaktoni atë për të rinovuar vërtetimin tuaj, i cili është gjithmonë i vlefshëm.
- Kohëzgjatja e vlefshmërisë e cila është shënuar në vërtetimin e azil kërkuesit ATDA nuk ka asnjë pasojë në lidhje me pagesën që i jepet azil kërkuesit.
- Kohëzgjatja e vlefshmërisë të vërtetimeve ATDA të cilat do të jepen duke filluar nga 11 maj do të evoluojnë : për procedurat normale, ATDA e parë do të jetë për 10 muaj dhe e dyta për 6 muaj ; për procedurat e shpejta, ATDA e parë do të jetë për 6 muaj dhe e dyta për të njëjtën kohëzgjatje ; për procedurat Dublin, nuk ka ndryshim.

Kam marrë mbrojtjen ndërkombëtare (refugjat, mbrojtje dytësore), si të përfitoj në lidhje me të drejtat e mia sociale ?

- Vetëm me paraqitjen e vendimit të OFPRA/CNDA të cilat vërtetojnë mbrojtjen tuaj dhe pa pritur t'ju dorëzohet një vërtetim për kërkesën e lejes së qëndrimit, ju mund të filloni të merrni të Ardhurat e Solidaritetit Aktiv (RSA).
- Të gjitha lejet e qëndrimit, afati i të cilave mbaron midis 16 marsit dhe 15 qeshorit do të shtyhen dhe 180 ditë (6 muaj). Kur të vijë momenti, 180 ditë pas datës të përfundimi e cila figuron në lejen tuaj të qëndrimit, ju mund të kërkonti rinovimin e saj duke konsultuar faqen e internetit të prefekturës nga vareni e cila do ju orientojë në lidhje me përçapjet e nevojshme që duhet të bëni.